

## Reflektime për vitin 2016 dhe zhvillimet e reja

**Bashkohuni me komunitetin e EPALE me më shumë se 20 000 specialistë të të nxënit për të rritur për të vlerësuar, komentuar dhe kontribuar!**

Të dashur kolegë të EPALE,



### **Gëzuar Vitin e Ri!**

Dëshirojmë t'ju falënderojmë që keni qenë pjesë e EPALE dhe t'ju urojmë të gjitha të mirat për vitin 2017. Ne do të vazhdojmë t'ju informojmë në lidhje me sektorin e të nxënit për të rritur në Europë dhe të punojmë për ta bërë EPALE të dobishëm për komunitetin tonë.

### **Artikuj në formë blogu**

#### **EPALE hedh shikimin mbrapa në vitin 2016**

Ne ju rikthyem një mijë materialeve të ndryshme të EPALE për të kuptuar se cilat ishin burimet dhe blogjet më popullore për vitin 2016.

## 7 postimet kryesore të EPALE në mediat sociale për vitin 2016

Hidhini një sy disa nga postimeve më popullore në mediat sociale për të kuptuar se cilat tema kanë ngjallur më shumë interes tek ndjekësit tanë në [Facebook \(linku është i jashtëm\)](#) dhe [Twitter\(linku është i jashtëm\)](#) gjatë vitit 2016.

### **Fokusi gjatë muajit shkurt: Përfitimet që rrjedhin nga të nxënit për të rriturit**

Në muajin shkurt EPALE do t'i kushtojë vëmendje të veçantë përfitimeve që rrjedhin nga të nxënit për të rriturit. Mos harroni të na vizitoni gjatë gjithë muajit shkurt për t'u njohur me materiale interesante në lidhje me efektet pozitive të të nxënit për të rriturit tek vetë ata, tek shoqëria dhe ekonomia.

### **Lajme nga mbarë Europa**



Janari ka qenë muaji i zhvillimeve të reja në sektorin e të nxënit për të rriturit në mbarë Europën:

- [Ministria Gjermane e Arsimit dhe Hulumtimit ka bërë publike një linjë të re telefonike](#) nëpërmjet të cilës njerëzit mund të marrin informacion në lidhje me mundësitë për arsimimin e vazhdueshëm (në gjuhën gjermane).

- Ndërkohë, Estonia është duke punuar për **dixhitalizimin e materialeve mësimore të arsimit të mesëm** për ta bërë atë më të aksesueshëm nga fëmijët dhe të rriturit jashtë Estonisë, si edhe për ata persona të cilët nuk janë në gjendje të ndjekin orë mësimi formale (në gjuhën angleze dhe estoneze).
- **Agjencia Norvegjeze për të Nxënit gjatë Gjithë Jetës do ta fillojë vitin 2017 me një emër tërësisht të ri – Skills Norway** (Kompetanse Norge) – pasi ajo beson që ky emër i ri e pasqyron më mirë vizionin e agjencisë (në gjuhën angleze).

### **Bashkohuni tani!**

Mos harroni të regjistroheni në EPALE për të qenë në gjendje që të ndani mendimet tuaja në këto postime. **Bashkohuni tani** dhe bëhuni pjesë e komunitetit të përbërë nga më shumë se 20 000 specialistë të të nxënit për të rriturit.